



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1048 / Prot. 16

Tiranë, më 21 / 12 /2016

VENDIM

Nr. 97, datë 21 / 12 /2016

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesit/ banorët e zonës që preken nga Hidrocentrali “Poçem”, përfaqësuar nga Av.

me prokurë të posaçme nr.1293 rep, nr.570 kol, datë 23.07.2016, kanë depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 1048Prot., datë 03.10.2016, ndaj Autoritetit Publik/ Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare”.

Ankuesit në cilësinë e kërkuesëve, me shkresën e datës 30.07.2016 kanë kërkuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë t’i vihet në dispozicion dokumentet zyrtare/informacion në lidhje me vendimmarrjen dhe procedurat e ndjekura për projektin “Ndërtimi i hidrocentralit të Poçemit, në rrjedhën e Vjosës deri në kuotën 70 m.a.s.l (poshtë hidrocentralit të Kalivaçit)”, i cili do të operohet si koncesioni i Hidrocentralit të Poçemit, nëpërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, si vijon:

1. Kopje të propozimit të pakërkuar të paraqitur nga shoqëria Çinar-San Hafriyat Nakliyat İnşaat Turizm Sanayi Ve Ticaret Limited Şirketi;
2. Kopje të studimit të kryer për shfrytëzimin e lumit Vjosa nga shoqëria Sogreah në vitin 2009;
3. Kopje të urdhërave për ngritjen e Grupeve të Punës/Komisionit të Koncesionit për shqyrtimin e propozimit të pakërkuar;
4. Kopje të marrëveshjes/kontratës me konsulentin e përzgjedhur nga BERZH, Mercados;
5. Kopje të procesverbaleve të takimeve/mbledhjeve dhe raporteve të Grupit të Punës/Komisionit të Koncesionit dhe/ose konsulentit Mercados për shqyrtimin e propozimit të pakërkuar;
6. Kopje të njoftimeve dhe të procesverbaleve të konsultimit me banorët e zonës që preken nga hidrocentrali (nëse ka pasur të tilla);
7. Kopje të Urdhërit të Ministrit që vendos për çeljen e procedurës së dhënies me koncesion;

8. *Kopje të akteve dhe procesverbaleve të Komisionit të Koncesionit që pasqyrojnë punën e Komisionit gjatë gjithë hallkave të procedurës sipas nenit 18, pika 5 dhe 6 të Ligjit nr.125/2013;*
9. *Kopje të kërkesave për sqarime të Dokumentave të Tenderit dhe përgjigjeve respektive;*
10. *Kopje të ofertës së paraqitur nga ofertuesi i shpallur fitues me të gjitha dokumentat përbërëse të saj;*
11. *Nëse është lidhur kontrata me fituesin, kopje të kontratës.*

Me shkresën nr. 411/1 Prot., datë 01.09.2016, Ministria e Energjisë dhe Industrisë i ka kthyer përgjigje kërkesëve duke sqaruar ndër të tjerat se:

- *Aktualisht, në bazë të procedurave të përcaktuara ligjore dhe të përfshira në Dokumentat Standarte të Tenderit (këto dokumenta dhe informacione të tjera janë publikuar në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik), është përfunduar faza e përzgjedhjes të firmës fituese dhe po negociohet Kontrata përkatëse e Koncesionit.*
- *Në fazën aktuale, referuar kushteve dhe klauzolave juridike të përcaktuara në Dokumentat Standarte të Koncesionit/ Partneritetit Publik Privat për ndërtimin e Hidrocentralit "Poçem", Shtojca 16 "Kushtet e Përgjithshme të Kontratës", neni 5 "Informacioni Konfidencial", MEI – Autoriteti Kontraktues është e/i detyruar të mbajë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratë. Në këto kushte, dokumentat e kërkesave për pikat 1, 9 dhe 10, nuk mund t'ju vihen në dispozicion.*
- *Në lidhje me kërkesën e pikës 2, për vënien në dispozicion të një kopjeje të studimit të kryer nga kompania "Sogreah", në vitin 2009, për shfrytëzimin e lumit Vjosa, MEI është kondicionuar pika 2.ç) e nenit 23 "Propozimet e pakërkua" të ligjit Nr.9663, datë 18.12.2006 "Për Koncesionet", i ndryshuar, si dhe urdhërit të ministrit të ish METE Nr.200, datë 11.03.2009, referuar këtij dokumenti. Bashkëngjitur gjeni një kopje të urdhërit.*
- *Për kërkesën e pikës 4, shoqëria "AF Mercados – EMI" SA Madrid Spanjë ofron konsulencë teknike për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë në zbatim të projektit "Rritja e kapaciteteve institucionale për Investimet nëpërmjet zbatimit të koncesioneve në hidroenergjë dhe industri. Asistencë për zhvillimin, dhënien dhe negocimin e koncesioneve për HEC-et e mëdhenj", financuar nga Banka BERZH, në zbatim të VKM Nr.607, datë 17.09.2014 "Për miratimin në parim të Marrëveshjes së Grantit Nr.C29314/NONC-2010-12.04, nëpërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministri i Financave dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për ndërtimin e Kapaciteteve për Koncesionet për Investimet në Energji dhe Industri në Shqipëri". Në këto kushte dokumentacioni që kërkohet nuk ka të bëjë me koncesionin e HEC-it Poçem.*
- *Në lidhje me kërkesat e pikave 3, 5, 7 dhe 8, që kanë të bëjnë me veprimtarinë e Komisionit të Koncesionit, bashkëngjitur gjeni një kopje të dokumentave.*
- *Në lidhje me kërkesën e pikës 6, që ka të bëjë me njoftimet dhe procesverbalet e konsultimit me banorët e zonës që preket nga hidrocentrali, do të vihen në dispozicion mbas përfundimit të procedurës përzgjedhëse, nënshkrimit të kontratës dhe përcaktimit nga ana e koncesionarit të parametrave të Projektit të Zbatimit. Aktualisht nuk është përcaktuar asnjë parametër apo e dhënë për kufijtë e shtrirjes të projektit të HEC-it Poçem.*

Pas refuzimit të dhënies së informacionit nga Autoriteti Publik/ Ministria e Energjisë dhe Industrisë, ankuesit pretendojnë se: "...me shkresën nr.411/1, datë 01.09.2016, MEI ka dhënë një informacion të pjesshëm, konkretisht vetëm për pikat 3,5,7 dhe 8 të kërkesës. Për pikën 11, sqaron se kontrata ende nuk është lidhur, pra nuk ekziston dokumenti i kërkuar, ndërsa për pikën 6, sqaron se informacioni i kërkuar do të vendoset në dispozicion vetëm pas nënshkrimit të kontratës. Për informacionin e kërkuar në pikat 1,2,4,9 dhe 10, MEI ka refuzuar dhënien e tij, me arsyetimin se informacioni i kërkuar në pikat 1,2,9 dhe 10 është informacion konfidencial dhe si i tillë nuk mund të vihet në dispozicion. Ndërsa informacionin e kërkuar në pikën 4, refuzon ta vendosi në dispozicion me arsyetimin se nuk ka lidhje me koncesionin e HEC Poçem". Në këto kushte ankuesit kërkojnë nga KDIMDP, ushtrimin e kompetencave që ju njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit/ dokumentacionit nga autoriteti publik.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri pas vlerësimit të ankesës, verifikimit të fakteve dhe bazës ligjore të saj, me Urdhrin nr. 217, datë 10.10.2016, urdhëroi kryerjen e inspektimit administrativ pranë Autoritetit Publik/ Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë. Pranë këtij autoriteti u depozitua Urdhri i inspektimit administrativ dhe u protokollua me nr. 411/2 Prot., datë 10.10.2016.

Gjatë inspektimit u konstatua se kërkesa është depozituar dhe protokolluar me nr. 411 Prot., datë 02.08.2016 pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe më pas i ka kaluar për trajtim Sektorit të Prokurimeve dhe Drejtorisë së Koncesioneve, Prokurimeve, Shpronësimeve dhe Privatizimit, të cilat me shkresën nr. 411/1 Prot., datë 01.09.2016 i kanë kthyer përgjigje kërkuësëve.

Lidhur me ankesën e banorëve të zonës që preken nga Hidrocentrali "Poçem", u kontaktua me Koordinatorin e të Drejtës për Informim dhe personat përgjegjës. Nga ana e përfaqësuesve të MEI u kërkuar kohë për përgatitjen e informacionit të nevojshëm, objekt inspektimi.

Pas kalimit të afatit të vendosur nga ana e grupit të inspektimit, Autoriteti publik/ MEI nuk paraqiti asnjë shkresë apo argument nga ana e personave përgjegjës.

Në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" në të cilin citohet se "Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ....kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve", me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, Komisioneri vlerësoi zhvillimin e një seance dëgjimore përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Me shkresën nr. 1048/3 Prot., datë 20.10.2016, Zyra e Komisionerit njoftoi palët në një seancë dëgjimore në datën 25.10.2016, ora 11:30 pranë ambienteve të Zyrës së Komisionerit.

Në seancën dëgjimore u paraqit vetëm Av. .... Pala ankuese kërkoi shtyrjen e seancës dëgjimore për shkak të mungesës së përfaqësuesve të Autoritetit Publik. Nga ana e Komisionerit u pranua kërkesa e Av. .... dhe me anë të shkresës nr.1048/4 Prot, datë 25.10.2016, palët u njoftuan për seancën e radhës.

Më datë 02.11.2016, ora 11:00 u paraqit për ankuesin Znj. .... e pajisur me autorizim nga Av. .... dhe Z. .... si përfaqësues i Autoritetit Publik/ Ministrisë së

Energjisë dhe Industrisë i pa pajisur me autorizim. Për shkak të mungesës së autorizimit nuk u zhvillua seanca dëgjimore.

Nga ana e Autoritetit Publik/ Ministria e Energjisë dhe Industrisë nuk u paraqit asnjë pretendim apo parashtrim në lidhje me kërkesat objekt i urdhërit të inspektimit.

Pas shqyrtimit të ankesës, inspektimit të ushtruar si dhe pas konsultimit të legjislacionit përkatës rezultoi se, informacioni/ dokumentacioni i kërkuar në pikat 3, 5, 7 dhe 8 të kërkesës i është vendosur në dispozicion ankuesëve. Ndërsa për sa i përket dokumentacionit që kërkohet në pikën 11, rezultoi se nuk është i regjistruar pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe si i tillë ai nuk administrohet prej kësaj të fundit.

Dokumentacioni i kërkuar në pikat 1,2,4,6,9 dhe 10 është i regjistruar pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe si i tillë ai administrohet prej kësaj të fundit. Ekzistenca e dokumentacionit pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga autoriteti publik, përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”.

Në lidhje me dokumentacionin e kërkuar në pikën 1 *“Kopje të propozimit të pakërkuar të paraqitur nga shoqëria Çinar-San Hafriyat Nakliyat İnşaat Turizm Sanayi Ve Ticaret Limited Şirketi”*; pikën 9 *“Kopje të studimit të kryer për shfrytëzimin e lumit Vjosa nga shoqëria Sogreah në vitin 2009”* dhe pikën 10 *“Kopje të ofertës së paraqitur nga ofertuesi i shpallur fitues me të gjitha dokumentat përbërëse të saj”*, Autoriteti Publik/ Ministria e Energjisë dhe Industrisë në shkresën nr. 411/1 Prot., datë 01.09.2016 pretendon se është konfidencial. Nga ana e MEI nuk u provua me asnjë dokument që dokumentacioni i kërkuar është konfidencial.

Vlerësohet se refuzimi i dhënies së dokumentacionit është bërë në kundërshtim me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Në qoftë se dokumentacioni i kërkuar përmban informacione të mbrojtura, nga ana e Autoritetit Publik duhen zbatuar përcaktimet e nenit 17 pika 6 ku citohet se: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*. Gjithashtu edhe në VKM-në Nr.575, datë 10.7.2013 *“Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/ partneritet publik privat”*, neni 14/2, përcaktohet qartë se *“Para nisjes së procedurës së përzgjedhjes, propozuesit do t’i kërkohet të identifikojë në mënyrë specifike pronësinë intelektuale, që lidhet me zgjidhjet teknike ose teknologjitë e reja, të cilat ata duan të mbrojnë. Klasifikimi i gjithë dokumentacionit të propozimit si sekret, nuk është i pranueshëm”*.

Bazuar në Ligjin nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik/ privat” dhe Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në rastet e procedurave elektronike Autoriteti Kontraktor detyrohet të bëjë publike kërkesat për sqarime të Dokumentave të Tenderit dhe përgjigjeve respektive.

Nën këto argumente ligjorë, vlerësohet se nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit/ dokumentacionit të kërkuar, pjesa tjetër duhet t’i vendoset në dispozicion ankuesëve.

tillë ai i duhet vënë në dispozicion ankuesit.

Për sa më lart personat përgjegjës për dhënien e informacionit të kërkuar duhet të procedojnë me dhënien e informacionit/ dokumentacionit duke respektuar në mënyrë specifike pronësinë intelektuale, sekretet tregtare ose të drejtat e tjera ekskluzive të parashikuara që përmenden në këto dokumenta në përputhje me Ligjin nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për Koncesionet”, i ndryshuar; Ligjin nr.125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe VKM-në Nr.575, datë 10.7.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/ partneritet publik privat”.

Theksojmë, se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksonimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e banorëve të zonës që preken nga Hidrocentrali “Poçem”, përfaqësuar nga Av. Vladimir Meçi, ndaj Autoritetit Publik/ Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

## **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 ‘Për të drejtën e informimit’, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’,

